



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
KOMITETI I EMËRIMIT DHE VLERËSIMIT TË INSPEKTORËVE

Nr. 2738/2 Prot.

Tiranë, më 03 . 10 .2025

V E N D I M

Nr. 51 datë. 03 . 10 .2025

**“PËR NDALIMIN E KANDIDIMIT TË Z. PARID SINELLA NË VENDIN
VAKANT PËR INSPEKTOR JOMAGJISTRAT, SHPALLUR NGA
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË MË DATË 27.05.2024”**

Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve i përbërë nga:

Znj. Elena Pelushi – Kryetar

Znj. Lindita Ziguri – Anëtar

Znj. Joana Sorraj- Anëtar

Asistuar nga Sekretariati teknik i përbërë nga:

Znj. Eljona Bylykbashi

Znj. Amanta Jasa

Znj. Zonje Shelqizi

Në mbledhjen e datës 3.10.2025, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

Kandidatit për inspektor jomagjistrat:

Z. Parid Sinella

OBJEKTI: Urdhërimi i ndalimit të z. Parid Sinella, në vendin vakant për inspektor jomagjistrat, të shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 27.05.2024.

Komiteti pasi u njoh me aktet si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, pikës 3 dhe 77, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", me njoftimin e datës 27.05.2024, në faqen zyrtare ka shpallur procedurën për 4 vende vakante për pozicionin e inspektorit jomagjistrat. Shpallja ka qenë e hapur për 30 ditë, periudhë gjatë së cilës do të administrohet kërkesa e të interesuarve, bashkë me dokumentacionin e renditur në shpallje.
2. Në përfundim të afatit të shpalljes, me urdhrin nr. 74 datë 26.06.2024 "Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e Inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", të ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka ngritur Komitetin e Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, si organi që do të zhvillojë procedurat përzgjedhëse për plotësimin e vendeve të shpallura.
3. Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, në përfundim të afatit për paraqitjen e aplikimeve për shprehje interesi për kandidim datë 26.06.2024, zhvilloi mbledhjen e parë më datë 02.07.2024, ku vendosi për shqyrtimin e dosjes që i përket çdo kandidati dhe fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve që kanë shprehur interes për vendin vakant për Inspektor Jomagjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë duke njoftuar në faqen zyrtare në rubrikën "Njoftime"; "Rekrutim Inspektorë Jo-Magjistratë" listën e personave të interesuar për vendin vakant dhe fillimin e shqyrtimit të aplikimeve të kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre, për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 209 dhe nenin 211, pika 2 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar dhe të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit".
4. Z. Parid Sinella, si një ndër kandidatët që ka shprehur interesin nëpërmjet kërkesës me nr. 1763 prot., datë 25.06.2024 për vendin vakant të Inspektor jomagjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është njoftuar me shkrim për tu paraqitur pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës bazuar në detyrimet ligjore, të përcaktuara

nga neni 209, neni 211, pika 2, të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësisë të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", si dhe urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë". Njoftimi me shkrim, i kryer në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidati, gjendet i administruar në dosjen e kandidimit.

5. Në datën 09.07.2024, kandidati z. Parid Sinella, është paraqitur pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe është pajisur me formularët e deklaramit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij. Kryerja e kësaj procedure vërtetohet nga nënshkrimi prej vetë kandidatis të Deklaratës përkatëse, e cila gjendet e administruar në dosjen e kandidimit.
6. Në datën 18.07.2024 kandidati z. Parid Sinella ka depozituar tek sekretariati teknik, formularët e deklaramit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, të cilat gjenden të administruara në dosjen e kandidimit.
7. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e pasurisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, si edhe në zbatim të seksionit A, të Kreut IV, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësisë të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jo magjistratë për pozicionin e inspektorit", me shkresën përcjellëse me nr. 2230 prot. datë 03.08.2024, i ka dërguar Inspektoratit të Lartë të Deklaramit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI), listën e kandidatëve dhe të personave të lidhur me ta, sikurse janë deklaruar prej vetë kandidatëve, që i nënshtrohen procedurës së deklaramit dhe kontrollit të pasurisë, si edhe kopjet e deklaratave të nënshkruara nga secili prej tyre.
8. Bashkëlidhur kësaj shkrese drejtuar ILDKPKI-së, ndërmjet të tjerave, është vendosur edhe Deklarata e nënshkruar nga kandidati z. Parid Sinella, ku deklarohet se, është pajisur me kredencialet dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, si edhe data e nënshkrimit, nga e cila fillojnë të llogariten afatet e përcaktuara nga ligji për përmbushjen e detyrimeve ligjore të kandidatis për procedurën e verifikimit të kandidaturës.

9. Kandidati z. Parid Sinella e ka përmbushur detyrimin për të plotësuar në sistemin EACID dhe dorëzuar si elektronikisht dhe fizikisht të plotësuar pranë ILDKPKI-së Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë.
10. ILDKPKI, në zbatim të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", me aktin nr. 200/23 prot., datë 13.12.2024, ka dërguar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin z. Parid Sinella dhe personat e lidhur me të.
11. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, të përcaktuara në nenin 209, pika 6, gërma "a" dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, si edhe në zbatim të seksionit C, të Kreut IV, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jo magjistratë për pozicionin e inspektorit", kandidati z. Parid Sinella ka depozituar diplomë nr. 7563, datë 05.07.2002 në degën drejtësi, lëshuar nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.
12. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit të kandidatit z. Parid Sinella, Inspektori i Lartë i Drejtësisë i është drejtuar me kërkesë për informacion edhe disa organeve ligjzbatuese, të cilët kanë kthyer përgjigjet përkatëse.
13. Në mbështetje të nenit 209, pika 6, gërmave "b" dhe "d", të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, me shkresën me nr. 2234 prot., datë 03.08.2024, sërisht lidhur me integritetin është kërkuar informacion pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, duke verifikuar mbi plotësimin e kriterëve të përcaktuara në pikën 1 të Kreut III dhe në zbatim të pikës 2, gërma "b" Kreu V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Gjithashtu, në zbatim të kriterit të përcaktuar në pikën 6, gërma "d" të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, për verifikimin e gjendjes gjyqësore të kandidatit z. Sinella, Inspektori i Lartë i Drejtësisë i është drejtuar me shkresën nr. 2235 prot., datë 03.08.2024, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, lidhur me verifikimin nëse ndaj kandidatit janë zhvilluar procese gjyqësore të karakterit penal, dhe nëse rezultojnë të dënuar, për efekt të gjendjes gjyqësore. Informacioni i kërkuar për sa më sipër, është përcjellë në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me shkresën nr. 8904/1 prot.,

datë 14.08.2024 të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe me shkresën nr. 13027/1 prot., datë 08.08.2024, të Drejtorisë të Përgjithshme të Burgjeve.

14. Për verifikim të mëtejshëm të kushteve të përcaktuara në nenin 209, pika 6, gërmave "b" dhe "d", të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, si dhe në pikat 59 dhe 60 të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", Inspektori i Lartë i Drejtësisë, i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, duke përcjellë formularin e vetëdeklarimit, sipas ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", të plotësuar nga kandidati jomagjistrat dhe ka kërkuar informacion për integritetin e kandidatit lidhur me ndonjë të dhënë apo indicie e ardhur nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimet e ngritura në kuptimin penal dhe atë të cenimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta, kopje të dokumentacionit që përmban të dhëna në rastet e identifikimit të kandidatit jomagjistrat në kontakte me persona të pa përshtatshëm.
15. Në funksion të verifikimit të kriterëve të përcaktuara në nenin 209, pika 6, gërmave "b" dhe "d", të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, Inspektori i lartë i Drejtësisë, i është drejtuar me kërkesë për informacion lidhur me çështje gjyqësore apo hetime penale në ngarkim të kandidatëve, gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, dhe prokurorive pranë tyre, Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, dhe Prokurorisë së Posaçme, të cilët kanë kthyer përgjigjet përkatëse.
16. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, që kanë të bëjnë me përvojën profesionale si "Jurist", jo më pak se pesëmbëdhjetë vite punë në çastin e kandidimit, në zbatim të nenit 209, pika 6, gërma "c", e ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", Inspektori i Lartë i Drejtësisë i është drejtuar me kërkesë për informacion Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtorisë së Arkivit Qendror me shkresën nr. 2232 prot, datë 03.08.2024, në lidhje me periudhën e derdhjes të kontributeve të sigurimeve shoqërore. Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 8503/1 prot, datë 09.08.2024, Drejtoria e Arkivit Qendror me shkresën nr. 8294/1 prot, datë 20.08.2024 dhe me shkresën nr. 18449/1 prot, datë 23.08.2024.

Me shkresat nr. 2228, datë 03.08.2024, nr. 2228/1 prot datë 03.08.2024 nr. 2228/2, datë 03.08.2024 dhe nr. 2215, datë 03.08.2024 nga ana e ILD-së është kërkuar informacion përkatësisht nga Agjencia Kombëtare e Kadastrës, Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore AMBU dhe Bashkia Tiranë duke kërkuar përshkrimin e hollësishëm të llojit të punës, kontratë

individuale nëse ka, rregullore, akte që kanë të përcaktuar detyrat ose përshkrim pune, gjatë kohës së punësimit si lidhur me pozicionet e punës dhe janë kthyer përgjigje duke përcjellë dokumentacionin e kërkuar. Institucionet kanë kthyer përgjigjet përkatëse.

17. Nga të dhënat e administruar në kuadër të verifikimit të pasurisë, dhe konkretisht aktit përfundimtar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë dhe interesave privatë për periudhën 03.03.2017-07.10.2019, konstatohet ushtrimi i një veprimtarie të pavarur profesionale për të cilën i është kërkuar shpjegime kandidatit, i cili i ka përcjellë me shkresën datë 30.06.2025 regjistruar në ILD me nr. 1919/1 prot., datë 30.06.2025. Në shpjegimet e tij, kandidati shprehet se: “..., në muajin Mars të vitit 2017 kam riaktivizuar veprimtarinë për ofrimin e shërbimeve juridike profesionale. Ushtrimin e aktivitetit e provoj duke ju vënë në dispozicion kopje të ekstraktit historik të regjistrit tregtar, lëvizjet në llogarinë bankare si person fizik, si dhe deklaratimet vjetore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për vitet 2017, 2018, 2019. Përsa i përket llojit të veprimtarisë, ju bëj me dije se veprimtaria ime ka qenë me kohë të pjesshme dhe ka qenë e fokusuar në fushën civile dhe administrative. Duke pasur në vëmendje parashikimet e ligjit nr. 9367/2015, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, shërbimet e ofruara nuk lidheshin me çështje që preknin veprimtarinë e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe ofrimi i tyre nuk ka ndikuar dhe as ka krijuar dukjen sikur ndikonte në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi që kisha si specialist në këtë institucion. Gjithashtu, sqaroj se, në periudhën Mars 2017 -Korrik 2019 kam ushtruar detyrën e specialistit dhe pozicioni im ishte i kategorisë ekzekutive. Më pas, në Korrik të vitit 2019 kam kaluar në pozicionin e përgjegjësit të sektorit, i cili ishte i kategorisë së ulët drejtuese. Për pasojë, nuk isha në kushtet e kufizimit të “interesave privatë për parandalimin e rasteve të veçanta të konfliktit të vazhdueshëm të interesave”, sikurse parashikon kreu III, seksioni 2, neni 31, i ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar. Rrethanat e mësipërme i vërtetoj duke ju vënë në dispozicion kopje të librave të shitjes të deklaruara në organet tatimore, lëvizjet e llogarisë bankare si person fizik dhe dokumentet që provojnë llojin e shërbimit të ofruar. Theksoj, se gjatë ushtrimit të detyrës shtetërore në atë kohë, në vlerësimet periodike vjetore, jam vlerësuar maksimalisht për punën që bëja nga eprori i drejtëpërdrejtë dhe nuk kam pasur asnjë masë disiplinore Në përfundim, deklaroj se: a) të ardhurat e siguruar nga aktiviteti si person fizik janë të ardhura nga burime të ligjshme pasi janë deklaruar në organet tatimore në kohë dhe janë paguar detyrimet tatimore; b) gjatë ushtrimit të veprimtarisë si person fizik nuk kam vepruar në kushtet e konfliktit të interesit me detyrën që ushtroja.”

17.1. Nga dokumentacioni i përcjellë nga kandidati, ndër të tjera, konkretisht ekstrakt historik i regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit “Person Fizik”, konstatohet si fushë veprimtarie “Avokat, konsulencë juridike, përfaqësime në gjykatë në të gjitha shkallët e gjykimit, përfaqësimin në gjykatën kushtetuese”, dhe me të dhëna për ushtrimin e aktivitetit “aktivizim” nga data 02.03.2017 dhe pezulluar 04.10.2019.

17.1.2. Gjithashtu ndër dokumentet e sjella nga kandidati janë edhe vendimet gjyqësore dhe deklaratë mbrojtje, kërkesë padi, ankim i veçantë, ku ai (kandidati) rezulton në cilësinë e avokatit të palës paditëse, të paditurit, personi i tretë. Kështu vendime të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë datë 05.06.2017 (përfaqësues i paditësit, persona fizik dhe të paditur Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë), 10.07.2017 (përfaqësues i paditësit, persona fizik dhe të paditur Drejtoria e Përgjithshme e Entit Kombëtar të Banesave), 29.01.2018 (përfaqësues i paditësit, person fizik dhe të paditur Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve), 06.03.2018 (përfaqësues i paditësit, person fizik dhe të paditur Bashkia Tiranë), 11.12.2018, 09.01.2020 (përfaqësues i paditësit, persona fizik dhe të paditur Bashkia Tiranë); të Gjykatës Administrative të Apelit datë 21.12.2017 (përfaqësues i paditësit, persona fizik dhe të paditur Komisioni i Prokurimit Publik); të Gjykatës së Lartë, Kolegji Administrativ datë 20.02.2018 (përfaqësues i paditësit, person fizik dhe të paditur Bashkia Tiranë); vendime të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë datë 19.06.2016 (përfaqësues i paditësit, persona fizik dhe të paditur Bashkia Tiranë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes); 20.06.2017 (përfaqësues i paditësit, persona fizik dhe të paditur Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes), 23.11.2017, 14.11.2017, 10.04.2018, 15.07.2019; deklaratë mbrojtje e qershor 2018; kërkesë padi e depozituar në gjykatë 05.07.2019; ankim i veçantë ndaj vendimit datë 15.07.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

17.2. Referuar shpjegimeve sa më sipër të kandidatit, më datë 02.07.2025, i është kërkuar të parashtrojë shpjegimet dhe të përcjellë dokumentacion mbështetës, mbi informimin e eprorit për çdo veprimtari me pagesë, jashtë detyrës në shërbimin civil dhe nëse kandidati disponon lejen me shkrim të institucionit për kryerjen e një veprimtarie të tillë. Me shkresën nr. 2192 prot., datë 17.07.2025 z. Sinella ka përcjellë shpjegime dhe dokumentacion ndër të tjera - deklaratë personale nga deklaruesi ku është shënuar emri “Arduen Karagozit” (si eprori i kandidatit në cilësinë e specialistit dhe të përgjegjësit të sektorit pranë Drejtorisë së Menaxhimit Strategjik, në AMBU) e shoqëruar me kopje librezë pune.

17.2.1 Në shpjegimet e tij, kandidati shprehet se: *“Eprori i drejtpërdrejtë ka qenë në dijeni për veprimtarinë time private, megjithatë nuk kam marrë pëlqim me shkrim të institucionit. Për të provuar këtë shpjegim po ju vë në dispozicion deklaratën e ish eprorit. Pavarësisht rrethanave të mësipërme, sjell në vëmendjen tuaj se ushtrimi i veprimtarisë private pa njoftuar eprorin direkt dhe njësinë e personelit konsiderohet si një nga shkeljet e rregullave të etikës në administratën publike. Referuar ndarjeve të shkeljeve në shërbimin civil, rasteve përkatëse për secilën prej tyre, ky veprim nuk parashikohet si një nga rastet e shkeljeve shumë të rënda apo të rënda, por si një nga rastet e shkeljeve të lehta. Në vijim, theksoj se ushtrimi i veprimtarisë private nuk ka shkaktuar pasoja në ushtrimin e detyrës shtetërore, për sa kohë që: i) nuk kam vepruar në kushtet e konfliktit të interesit me detyrën zyrtare; ii) nuk më ka penguar në*

kryerjen e detyrave si nëpunës civil; iii) kam përmbushur në kohë dhe në afat të gjitha detyrat e ngarkuara duke mbrojtur në çdo rast interesin publik; iv) kam vepruar gjithmonë në përputhje me parimet e përgjithshme të etikës në administratën publike. Rrethana që vërtetohen nga dokumentet që provojnë llojin e veprimtarisë së ushtruar dhe formularët e vlerësimit të punës për vitet 2017, 2018, 2019.”

17.3. Në vijim, përmes emailit të datës 18.07.2025 është vlerësuar e nevojshme t'i kërkohej kandidatit, shpjegime shtesë lidhur me ushtrimin e veprimtarisë profesionale të avokatisë në të njëjtën periudhë me atë të detyrës tek Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore. Shpjegimet e përcjella nga kandidati janë regjistruar në ILD me nr. 2216 prot., datë 21.07.2025, në të cilat ai shprehet ndër të tjera se: “... Në kushtet kur të ardhurat familjare ishin të pamjaftueshme për të krijuar kursimet e nevojshme, rifillimi i kësaj veprimtarie synonte vetëm përmbushjen e nevojave jetike nëpërmjet punës së ndershme. ... Për sa më sipër, kërkoj nga Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve të vlerësojë situatën e mësipërme duke marrë në konsideratë: a) rrethanat objektive dhe personale në të cilat është ushtruar veprimtaria si avokat; b) qëllimin e qartë për të siguruar të ardhura përmes punës së ndershme dhe burimeve të ligjshme; c) mungesën e pasojave negative në ushtrimin e funksioneve të mia publike dhe profesionale. ...”

17.4. Nga verifikimet e kryera lidhur me dokumentacionin e sjellë nga ana e vetë ankuesit në shpjegimet sa më sipër, është konstatuar se kandidati ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes me nr. 90003-02877-30-2019 në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me vendimin datë 18.01.2021. Në seancën e kësaj date rezulton se kandidati ka marrë pjesë në cilësinë e avokatit të palës kërkuese duke shprehur qëndrimin e tij. Marrja pjesë në këtë cilësi në datën 18.01.2021 rezultonte të ishte kryer në periudhën kur sipas "ekstrakti historikut regjistrir tregtar datë 17.06.2025"-dokument i sjellë nga vetë kandidati, ky aktivitet ishte me status “i pezulluar” dhe në periudhën kur nga informacioni i Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë, ishte me status pasiv. Në këto kushte, bazuar në vendimin nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësisë të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë, për pozicionin e inspektorit”, pika 19 e tij, është vlerësuar duke i kërkuar shpjegime shtesë kandidatit. Ky i fundit ka përcjellë shpjegimet e tij, shoqëruar me dokumentacionin përkatës, të regjistruar në ILD me nr. 2721 prot., datë 02.10.2025. Në shpjegimet e tij, kandidati shprehet ndër të tjera se: “... Licencën e ushtrimit të profesionit të avokatit e kam aktivizuar për herë të parë në vitin 2013. Për sa i përket viteve 2015, 2016 deklaroj se kam qenë në status pasiv. Për vitin 2020, sqaroj se kam paguar tarifën vjetore të licencës pasi isha në negociatë për të filluar punë në një kompani ndërkombëtare, e cila kërkonte licencën e avokatisë, por për shkak të pandemisë, ky objektiv nuk u realizua. Theksoj se gjatë viteve të pezullimit të aktivitetit privat nuk kam realizuar të ardhura. Për vërtetimin këtij deklarimi po ju vë në dispozicion vërtetimin nr.258 prot., datë 26.9.2025, të Dhomës së Avokatisë të Shqipërisë. ... Lidhur me marrjen pjesë në shqyrtimin e

ankimit të veçantë me palë kërkuese Fadil Spahiu në Gjykatën e Apelit Tiranë në datë 18.1.2021, sqaroj se me shtetasin Fadil Spahiu (i cili ka ndërruar jetë) jam prezantuar nga djali i tij Fillimisht shtetasi më kontaktoi e më kërkoi t'i jepja një mendim lidhur me rrugën që duhet të ndiqte babai i tij për regjistrimin e truallit të banesës ku ai banonte.... Sikurse rezulton nga dokumentacioni që kam depozituar, gjykata e rrethit e rrëzoi kërkesën dhe pasi vendimi më është komunikuar nëpërmjet postës elektronike nga sekretaria gjyqësore, kam hartuar dhe kam paraqitur ankimin brenda afateve ligjore. Për të vërtetuar këtë shpjegim, po ju vë në dispozicion kopje të email-it të sekretarisë gjyqësore për njoftimin e vendimit të gjykatës së rrethit. Në vijim, e njoftoj për datën e zhvillimit të procesit gjyqësor në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe për faktin që e kisha pezulluar aktivitetin. Megjithatë, i ndjeri duke pasur konsiderata për personin tim, më kërkoi ta përfaqësoja dhe në apel. Nisur nga fakti që ishte në pleqëri të thellë (95 vjeç) gjendja shëndetësore në të cilën ndodhej vendosa ta përfaqësoj pa asnjë pagesë. Për vërtetimin e këtij shpjegimi, po ju paraqes deklaratën personale të djalit të tij....”

18. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit të parashikuar në nenin 209, pika 6, gërma "ç", e ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar dhe seksionit C të kreut IV, të vendimit nr. 536, date 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë, për pozicionin e inspektorit", u vlerësua t'i drejtohem me kërkesë për informacion Dhomës Kombëtare të Avokatisë me nr. 2238 prot., datë 03.08.2024 duke kërkuar nëse kandidati, në mënyre aktive, ka ushtruar profesionin e avokatit të paktën në dy vitet e fundit. Dhoma Kombëtare e Avokatisë është përgjigjur me shkresën nr. 350 prot., datë 04.09.2024.
19. Gjithashtu, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të nenit 209, pika 6, gërma "e", të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, dhe pikës 62, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", Inspektori i Lartë i Drejtësisë i është drejtuar Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit nëse secili kandidat, përfshihet në rastin e posaçëm të nenit 209, pika 6, gërma "e", e ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar: "e) ka qenë ose jo anëtar, bashkëpunëtor ose të favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit para 2 korrikut 1991" apo në njërin nga rastet e pikës 2, të nenit 29, të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë". Me shkresën nr. 2231 prot, datë 03.08.2024, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka dërguar formularin e aplikimit përkatës të plotësuar sipas ligjit nga kandidati i sipërcituar, për kompetencë dhe shqyrtim Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-

Sigurimit të Shtetit. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën nr. 1312/3 prot, datë 20.08.2024 ka dërguar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, informacionin, i cili është bashkëngjitur praktikës së kandidatit (*Vendim nr.501, datë 20.08.2024* i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit).

20. Në vijim të procedurave të verifikimit që lidhet me integritetin e kandidatëve për inspektor jomagjistratë si dhe për të shmangur çdo lloj konflikti interesi që bie ndesh me nenin 209, pika 6, gërmat “dh”, “ë” dhe “f” të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë", të ndryshuar është njoftuar zyrtarisht secili kandidat që të plotësojë formularët përkatës që lidhen me:
- mospasjen e funksioneve politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit;
 - mosqenien bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të ndonjë shërbimi sekret;
 - mosqenien anëtarë të organeve drejtuese të ndonjë grupi interesi, të tilla si shoqata ose sindikata etj., në kohën e kandidimit.
21. Për sa i takon kandidatit z. Parid Sinella, është paraqitur në ambientet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe ka dorëzuar të plotësuar secilin prej formularëve të mësipërm. Gjithashtu në funksion të verifikimit sipas gërmave “dh” dhe “f”, është proceduar edhe me kërkim informacion nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e cila ka kthyer përgjigjet përkatëse sipas shkresës me nr. 3572/1, datë 13.06.2025.
22. Në përfundim të veprimeve dhe procedurave të kontrollit dhe verifikimit, në zbatim të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 " Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, pikës 27 e vijues të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë, për pozicionin e inspektorit”, urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Komiteti ka proceduar me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm.
23. Në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, të C, të Kreut IV vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë, për pozicionin e inspektorit”, Urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të

Drejtësisë, "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", Kryetari i Komitetit të Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve ka thirrur mbledhjen e Komitetit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 03.10.2025, rendin e ditës, si edhe duke i bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës është përfshirë edhe çështja me objekt shqyrtimin e aplikimit të kandidimit të z. Parid Sinella, për vendin vakant për inspektor jomagjistrat në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

II. Vlerësimi i Komitetit

24. Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të zbatueshme për çështjen në shqyrtim, si edhe në rrethanat e faktit që rezultojnë nga aktet që përmban dosja e kandidimit, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për ndalimin e kandidimit të kandidatit z. Parid Sinella për vendin vakant për Inspektor jomagjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
25. Në nenin 209, pika 6, gërma "b" e ligjit nr. 115/2016, parashikohet si kusht që kandidati duhet të ketë integritet të lartë moral dhe përgatitje të lartë profesionale. Nga dokumentacioni i shqyrtuar, gjatë procesit të verifikimit rezulton se kandidati është i përfshirë në shkelje të ligjit me nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" të ndryshuar, e konkretisht nenit 47 të tij "Detyrimi i deklarimit të interesave dhe pasurisë", ku në pikën 1 parashikohet se: *"1. Nëpunësi civil ka detyrimin të informojë paraprakisht eprorin e tij për çdo veprimtari me pagesë që kryen jashtë detyrës së tij në shërbimin civil dhe mund të kryejë një veprimtari të tillë vetëm me lejen me shkrim të institucionit"*; si dhe të ligjit organik të avokatisë "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë", në fuqi për periudhën e ushtrimit të kësaj veprimtarie nga ana e kandidatit, e konkretisht me ligjin nr. 9103/2003 i ndryshuar, ku në nenin 4 parashikohet se: *"Avokati, gjatë ushtrimit të profesionit të tij, nuk mund të jetë, njëkohësisht, gjyqtar, prokuror, noter, nëpunës civil ose punonjës i administratës publike"*, dhe në vazhdim me ligjin aktualisht në fuqi me nr. 55/2018 ku në nenin 7 pika 1 parashikohet se: *"1. Avokati, gjatë ushtrimit të profesionit, nuk mund të kryejë njëkohësisht detyrën e gjyqtarit, prokurorit, noterit, përmbauesit gjyqësor, si dhe asnjë funksion apo detyrë tjetër në organet publike, me përjashtim të mësimdhënies në institucionet e arsimit të lartë, brenda ose jashtë vendit."* dhe në nenin 19 të pika 1 *"Avokati ndërpret ushtrimin e profesionit në rastin kur është emëruar në një pozicion, i cili krijon papajtueshmëri me ushtrimin e profesionit të avokatit, sipas parashikimeve të nenit 7 të këtij ligji. Avokati, në këtë rast, depoziton pranë Dhomës të Avokatisë të Shqipërisë, një deklaratë me shkrim ose çdo dokument tjetër që vërteton fillimin e marrëdhënieve të reja të punës. ... 3. Kërkesa për ndërprerje të lejes së ushtrimit të profesionit, sipas rasteve të parashikuara në këtë nen, shoqërohet*

me vërtetimin përkatës për pezullimin e veprimtarisë tregtare, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.”

Gjithashtu është evidentuar ushtrimi i profesionit të avokatit edhe në kohën kur ai kishte ndërprerë këtë veprimtari profesionale dhe kishte kaluar në regjistrin pasiv, duke rënë kështu ndesh me parashikimet e ligjit organik për ushtrimin e veprimtarisë së avokatit, të sipërcituar, e konkretisht nenit 14 ku parashikohet se: “1. Profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë mund të ushtrohet nga çdo person, që ka fituar titullin profesional “Avokat” dhe që përmbush kriteret e mëposhtme: a) të jetë pajisur me lejen vjetore të ushtrimit të profesionit të avokatit. Leja vjetore e ushtrimit të profesionit të avokatit është një dokument zyrtar, që lëshohet nga Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë dhe përmban të dhëna në lidhje me identitetin e avokatit, Numrin e Identitetit Personal të avokatit, dhomën vendore të avokatisë, ku avokati ushtron profesionin dhe periudhën e vlefshmërisë së lejes; b) të jetë regjistruar në regjistrin tregtar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për regjistrimin e biznesit, dhe të jetë pajisur me Numrin Unik të Identifikimit të Subjektit (NUIS); c) të zbatojë dispozitat ligjore dhe ato të parashikuara në statut dhe në Kodin Etik të Avokatit; ç) të ketë përmbushur detyrimet ligjore, në lidhje me sigurimin e përgjegjësisë profesionale; d) të ndjekë programin e trajnimit vazhdues, në përputhje me parashikimet e këtij ligji. 2. Avokati regjistrohet në regjistrin e avokatëve aktivë, vetëm pas plotësimit të kriterëve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni. Regjistri i avokatëve aktivë mbahet nga Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë dhe dhoma vendore përkatëse, pranë të cilës avokati ushtron aktivitetin. ... 5. Mosplotësimi i detyrimeve të parashikuara në pikat 2, 3 dhe 4, të këtij neni, përbën shkak për fillimin e procedimit disiplinor ndaj avokatit.”.

Po kështu, referuar të dhënave sa më sipër të sjellë nga vetë kandidati, e konkretisht vendimeve gjyqësore ku ai ka qenë në cilësinë e avokatit, evidentohet fakti që ndërkohë që kandidati ushtronte detyrën në institucione shtetërore ai ka ushtruar veprimtarinë e avokatisë, si përfaqësues të një pale të një subjekti fizik privat me të paditur institucione shtetërore, e cila në dukje cënon imazhin e nëpunësit të administratës publike referuar etikës në administratën publike, sipas ligjit në fuqi.

26. Nga të dhënat sa më sipër, rezulton se në veprimtarinë e kandidatit para kandidimit janë vënë re sjellje në kundërshtim me detyrimet që parashikonte ligji përkatës organik për ushtrimin e funksioneve të tij si nëpunës civil, por edhe nga ana tjetër e ushtrimit të profesionit të avokatit, dhe si të tilla që afektojnë në detyrimin profesional, të korrektesës dhe respektit ndaj rregullave të procedurës në ushtrimin e funksioneve profesionale, elemente këto vlerësues dhe cilësues të integritetit referuar kushteve të parashikuara në nenin 209, pika 6, gërma “b” e ligjit me nr. 115/2016, i ndryshuar. Në vlerësim të këtyre rrethanave, çmohet se në rastin konkret nuk përmbushet kushti në fjalë.

27. Komiteti vlerëson të ritheksojë se kushtet e kandidimit për Inspektor Jomagjistrat në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të parashikuara nga Kushtetuta dhe ligjet e nxjerra në pajtim me të, duhet të plotësohen secila dhe të gjitha së bashku në mënyrë që kandidati të pranohet për t'u vlerësuar dhe renditur sipas meritave nga Komiteti. Në rast se kandidati nuk plotëson qoftë edhe njërin prej kushteve ligjore të kandidimit, kjo do të përbënte motiv ligjor të mjaftueshëm për Komitetin e Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve për të disponuar ndalimin e kandidimit, pa qenë më e nevojshme të arsyetojë për plotësimin ose jo të kushteve të tjera ligjore.
28. Për këto arsye, në zbatim të nenit 209 dhe nneit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, Komiteti vjen në përfundimin se kandidati Parid Sinella është në kushtet e ndalimit për shkak të mosplotësimit të kushtit ligjor të parashikuar nga neni 209, pika 6, gërma "b" të ligjit nr. 115/2016.
29. Nisur nga sa analizohet dhe arsyetohet me sipër, bazuar në gjetjet dhe të dhënat e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit që rezultojnë nga aktet dhe dokumentacionin që përmban dosja e kandidimit, në interpretim dhe zbatim të ligjit të zbatueshëm për kushtet dhe kriteret e kandidimit për Inspektor jomagjistrat, Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve vjen në përfundimin se duhet të vendoset ndalimi i kandidimit të kandidatit z. Parid Sinella, në vendin vakant për Inspektor jomagjistrat, të shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 27.05.2024,

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" të ndryshuar, pikave 27 "b", 28 "a" dhe "b", 30, 31, 72, 73, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë" Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve:

V E N D O S I:

1. Ndalimin e kandidimit të kandidatit z. Parid Sinella, në vendin vakant për inspektor jomagjistrat, i shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datë 27.05.2024.
2. Ky vendim i njoftohet kandidatit z. Parid Sinella.

3. Kandidati ka të drejtën e ankimit në gjykatën kompetente, brenda afatit ligjor.
4. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.


KOMITETI I EMËRIMIT DHE VLERËSIMIT TË INSPEKTORËVE

ANËTAR

KRYETAR

ANËTAR

Lindita Ziguri



Elena Pelushi



Joana Sorraj

